



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

DEPARTAMENTI PËR INTEGRIME EVROPIANE DHE KOORDINIM TË POLITIKAVE
DIVIZIONI PËR KOORDINIM TË POLITIKAVE

Raport i Punës

së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal

Janar-Dhjetor, 2016

Prishtinë, Janar, 2017

Ky raport paraqet punën e MAPL-së për periudhën Janar-Dhjetor të vitit 2016.

Raporti përmbledhë aktivitetet e të gjitha njësive organizative të MAPL-së duke u koncentruar në pesë fusha kryesore, të cilat përbëjnë objektivat e punës së ministrisë.

Raporti është produkt i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal – MAPL.

Përmbajtja

Shkurtesat.....	4
Hyrje.....	5
Përmbledhje ekzekutive	6
1. Zhvillimi dhe Zbatimi i Legjislacionit	9
2. Zhvillimi i politikave nga fusha e vetëqeverisjes lokale.....	13
3. Koordinimi institucional dhe promovimi ndërkombëtar i vetëqeverisjes lokale.....	15
4. Agjenda evropiane	18
5. Ngritja e kapaciteteve institucionale të komunave.....	21
6. Performanca Komunale	22
7. Promovimi i të drejtave të njeriut në Komuna	23
8. Promovimi i transparencës.....	25
9. Administrata dhe Financat	28
10. Auditimi	28
11. Prokurimi	29

Shkurtesat

AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
BNK	Bashkëpunimi Ndërkufitar
DEMOS	Decentralizimi dhe Mbështetja e Komunave
DIEKP	Departamenti për Integritime Evropiane dhe Koordinim të Politikave
DIE	Divizioni për Integritime Evropiane
DKP	Divizioni për Koordinim të Politikave
GIZ	Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim
IE	Integritimet Evropiane
IKAP	Instituti Kosovar për Administratë Publike
IPA	Integrimi para anëtarësimit
KASH	Korniza Afatsmesme e Shpenzimeve
KE	Komisioni Evropian
KEVL	Karta Evropiane për Vetëqeverisje Lokale
KCSF	Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MF	Ministria e Financave
MKRS	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
NJDNJK	Njësi për Drejtat e Njeriut në Komuna
OSCE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim Evropian
PKZMSA	Plani Kombëtar për Zbatimin e MSA-së
RAE	Rom, ashkali dhe egjiptas
SVL	Strategjia për Vetëqeverisje Lokale 2016 – 2026
SMP	Sistemi për Menaxhimin e Performancës
UNDP	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
USAID	Agjensioni për Zhvillim Ndërkombëtar
ZKM	Zyra e Kryeministrit

Hyrje

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) në përputhje me mandatin e saj ligjor, deklaratën prioritarë afatmesme të MAPL-së 2014–2016, si dhe objektivat e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016–2026 është përqendruar në përmbushjen e Planit të Punës për periudhën Janar-Shtator 2016. Raporti pasqyron veprimet dhe rezultatet e arritura sipas fushave të planifikuara:

- Zhvillimi dhe Zbatimi i Legjislacionit;
- Zhvillimi i politikave nga fusha e vetëqeverisjes lokale;
- Agjenda evropiane;
- Ngritja e kapaciteteve institucionale të komunave;
- Performanca Komunale;
- Promovimi i të drejtave të njeriut në Komuna;
- Promovimi i transparencës;
- Administrata dhe financat;
- Auditimi; dhe
- Prokurimi.

Raporti bazohet në të dhënat periodike të departamenteve të MAPL-së, përkatësisht:

1. Departamentit për Bashkëpunim dhe Zhvillim Rajonal;
2. Departamentit për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave;
3. Departamentit Ligjor dhe për Monitorim të Komunave;
4. Departamentit për Performancë dhe Transparencë në Komuna;
5. Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
6. Divizioni për Komunikim dhe Informim;
7. Divizioni i Auditimit të Brendshëm;
8. Divizioni i Veçantë i Prokurimit.

Përmbledhje ekzekutive

Përgjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka përmbushur një pjesë të rëndësishme të detyrave të planifikuara nga dokumentet e ndryshme strategjike, të inkorporuara në Planin e Punës për vitin 2016. Planifikimi i aktiviteteve është bërë edhe në Kornizën e Planit të Punës së MAPL-së për vitin 2017, të bazuar në prioritetet e Strategjisë për Vetëqeverisjen Lokale.

MAPL ka realizuar aktivitetet konform përgjegjësive dhe planifikimeve të bëra, duke përfshirë: monitorimin e komunave, procesin e vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale, matjen e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve për qytetarë, zhvillimin e transparencës komunale, bashkëpunimin ndërkomunal dhe ndërkufitar, koordinimin dhe sigurimin e zbatimit të obligimeve të komunave nga agjenda evropiane, etj.

Gjatë kësaj periudhe (janar – dhjetor, 2016) janë pranuar dhe shqyrtuar kërkesat e komunave për konsultim paraprak. Janë gjithsej 25 akte të cilat janë shqyrtuar paraprakisht, me të cilat komunat kanë marrë përgjigjet e nevojshme për mënyrën e adresimit të çështjeve brenda kompetencave të tyre. Me qëllim të sigurimit të qëndrueshmërisë së sistemit të vetëqeverisjes lokale, MAPL ka ofruar mbështetjen në shqyrtimin e politikave të ministrive të linjës, duke vlerësuar ndikimin dhe përputhshmërinë e 37 akteve dhe dokumenteve të propozuara me legjislacionin për vetëqeverisje lokale.

Në kuadër të kompetencave mbikëqyrëse, MAPL ka shtrirë aktivitetet e saja në monitorimin e punës së organeve të komunës. Nga ky aspekt, janë monitoruar 328 mbledhje të kuvendeve të komunave, për të cilat janë hartuar raportet përkatëse. Monitorimi i komunave është realizuar edhe me pjesëmarrje të drejtpërdrejtë, sipas Planit për monitorimin e drejtpërdrejtë të organeve të komunës. Vëmendje e veçantë i është kushtuar shqyrtimit të ligjshmërisë së akteve të kuvendeve të komunave. Prej 1692 akteve të aprovuara nga kuvendet e komunave, 1037 janë adresuar për vlerësim të ligjshmërisë në ministrinë e linjës, kurse 653 janë vlerësuar nga MAPL. Gjatë kësaj periudhë janë konstatuar 39 akte të kundërligjshme, për të cilat janë dërguar kërkesat për rishqyrtim. Kërkesa për rishqyrtim u janë adresuar komunave: Gjakovë, Leposaviq, Gjilan, Ranillug, Shtërpcë, Graçanicë, Gjakovë, Zubin Potok, Novobërdë, Dragash, Klinë, Gllogoc, Prishtinë. Po ashtu, MAPL ka adresuar në komuna 38 kërkesa për rishqyrtim të dhëna nga ministrinë sektoriale.

Gjatë periudhës së raportimit, MAPL ka hartuar 4 raporte të rregullta mbi funksionimin e kuvendeve të komunave (në baza periodike), 4 raporte për monitorimin e akteve të komunave, 5 raporte në fushën e financave lokale, 2 në lidhje me opinionet e auditorit për komuna për periudhat 2013/2014 dhe 2014/2015, 2 për investimet kapitale në komuna, 1 raport për skemën e granteve të financuara nga BE për komuna, 1 për marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkomunal dhe 2 për sfidat e komunave, si dhe ka hartuar 19 raporte të ndryshme në fushën e të drejtave të njeriut, përfshirë: barazinë gjinore, funksionimin e NJDNJK-ve në komuna, kundër trafikimit, të drejtat e komuniteteve, përdorim të gjuhëve, të drejtat e fëmijëve, etj. Po ashtu, janë hartuar 4 raporte të punës së MAPL-së për periudhat, 2 raporte për zbatimin e vendimeve të Qeverisë, 1 raport për obligimet që dalin nga dokumentet strategjike dhe koncept-dokumentet, si dhe analizat periodike të zbatimit të planit të punës së MAPL-së. Në kuadër të

aktiviteteve për koordinim të brendshëm dhe të jashtëm, është hartuar Doracaku për Koordinim të politikave, me të cilin përcaktohen përgjegjësitë e njësive në çështjet e lidhura me hartimin e politikave, planifikimin, organizimin, monitorimin dhe raportimin. Pjesë e këtij dokumenti është edhe Pyetësi i integruar i raportimit të komunave, ndërkaq janë hartuar një numër i udhëzuesve të brendshëm, për të koordinuar më mirë aktivitetet në fushat si: menaxhimi i projekteve që financohen nga MAPL, prokurimin publik, procedurat e rekrutimit, ciklin e pagesave, udhëzuesi për përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, si dhe dokumenti “*Profili i Komunave të Kosovës*”, i cili ka përfshirë një ekzemplar prej 500 kopjeve në tri gjuhë.

Në periudhën janar – dhjetor, 2017 MAPL ka zhvilluar: 1. Koncept-Dokumentin për menaxhimin e pronës komunale, 2. Koncept-Dokumentin për Akademinë për Vetëqeverisje Lokale (i pa finalizuar), 3. Koncept-Dokumentit për Zhvillim Ekonomik-Lokal (i dorëzuar në SKQ) dhe 4. Koncept-Dokumentit për Zhvillimin Rajonal (Pas pranimit të opinionit nga Ministria e Financave do të dorëzohet në SQK (brenda muajit janar 2017).

Një nga prioritetet kyçe të kësaj periudhe ka qenë zbatimi i aktiviteteve të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale, e cila është aprovuar nga Qeveria në fund të vitit 2015. Sipas propozimit të MAPL-së, Qeveria ka aprovuar Vendimin për themelimin e Grupit Drejtues për zbatimin e SVL-së. Grupi Drejtues ka mbajtur takimin e parë informues lidhur me hapat që duhet ndjekur për monitorimin e zbatimit të SVL-së. Aktivitetet promovuese të strategjisë, në përfshirje të palëve përgjegjëse për zbatimin e saj, janë vendosur në Planin për promovimin e SVL-së. Në prani të komunave, organizatave joqeveritare, bizneseve lokale dhe përfaqësuesve të mediave, janë mbajtur 5 punëtori regjionale për promovimin e SVL-së. Gjithashtu, janë botuar 500 ekzemplarë të kësaj strategjie. Me qëllim të realizimit të planit të veprimit të kësaj strategjie, janë hartuar 2 Raporte për zbatimin e Strategjisë për Vetëqeverisje lokale, si mjet që identifikon të gjithë hapat e ndërmarrë gjatë kësaj periudhe.

Progres është arritur edhe në fushat e tjera të rëndësishme, siç është mbështetja financiare e projekteve të komunave dhe organizatave joqeveritare. Janë pranuar 81 kërkesa për financim të projekteve të komunave, nga të cilat janë aprovuar 44 projekte për 31 komuna, vlera e të cilave ka kap shumën prej 3,499,815.00€. Nga kjo vlerë janë përfunduar 41 projekte, kurse në proces të përfundimit pas bartjes në vitin 2017 janë 3 projekte. Vlera e projekteve të paguara është 3.327.180,16€. Buxheti është shpenzuar në 2016 në masën e 96. Nga fondet e BE-së (IPA I faza e VII) të gjitha projektet kane përfunduar (*është bërë pranimi teknik*), në vlerë prej 15.3 milion€. Në këtë periudhë është përgatitur edhe drafti final i realizimit të projekteve për vitin 2015. Po ashtu ka rifilluar ndërtimi i objekteve komunale të mbetura nga IPA I-faza e IV dhe V. Objektet nga IPA I Faza e VI kanë përfunduar të gjitha, përveç një objekti në Komunën e Graçanicës. MAPL ka financuar edhe 17 projekte të organizatave joqeveritare në vlerën prej 203,643.00 euro, për zbatimin e objektivave të SVQL.

Nga prioritetet e tjera, MAPL ka vendosur shtrirjen e aktiviteteve për avancimin bashkëpunimit ndërkomunal dhe ndërkufitar. Përmes zbatimit të tri Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar (programe të cilat financohen nga Bashkimi Evropian), është bërë nxitja e bashkëpunimit ndërkufitar me tri vendet fqinje: Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë. Për të mbështetur komunat në këtë fushë është

hartuar Udhëzuesi për bashkëpunimin ndërkomunal dhe komunal ndërkombëtar, si dhe MAPL ka nënshkruar edhe kontratën me një kompani për zbatimin e projektit *“Zhvillimi i Solucioneve të integruara të IT-se për komunat*.

Nga agjenda evropiane janë ndërmarrë veprime të rëndësishme për koordinimin e aktiviteteve rreth përmbushjes së obligimeve që dalin nga procesi i integritit evropian. Është bërë finalizimi i matricës gjithëpërfshirëse *“Obligimet e Komunave nga agjenda evropiane për vitin 2016”*, si dhe janë përgatitur Planet individuale të veprimit për 38 komunat. Në këtë kontekst, ka vazhduar realizimi i vizitave në komuna lidhur me përmbushjen e obligimeve për raportim nga agjenda evropiane. Gjatë kësaj periudhe janë koordinuar veprimet për zbatimin e obligimeve që dalin në këtë proces. Gjithashtu, janë hartuar tri (dhe një ende është një proces) raporte periodike lidhur me përmbushjen e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane. Krahas kësaj, është përgatitur analiza 6 mujore për përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane për MAPL-në dhe analiza 6 mujore për përmbushjen e obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për komuna. MAPL ka mbajtur takime të rregullta me donatorë dhe partnerë implementues për mundësinë e mbështetjes së projekteve nga plani i punës 2016 dhe për mundësinë e bashkëpunimit në vitin 2017. Kurse, lidhur me koordinimin ndërinstytucional për procesin e integritit evropian, janë mbajtur 67 takime të përbashkëta me MIE-në, Kolegjiumin për IE (AKK), institucionet e tjera qeveritare dhe joqeveritare.


Në fushën e ngritjes së kapaciteteve në nivelin lokal, MAPL ka hartuar Planin me temat e trajnimeve 2016. Për shkak të specifikave të caktuara, janë hartuar Plane të veçanta për ngritje të kapaciteteve për komunat: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin-Potok. MAPL në bashkëpunim me IKAP-in, ka mbajtur 146 trajnime, në të cilat janë trajnuar 2338 zyrtarë komunal. Trajnimet për zyrtarët e komunave janë ofruar edhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar. Në bashkëpunim me OSBE-në, MAPL ka realizuar 16 trajnime fillestare për ish-pjesëtarët e mbrojtjes civile, në të cilat janë trajnuar 378 zyrtarë të komunave. Për nevoja të paraqitjes së të arriturave të komunave gjatë kryerjes së shërbimeve për qytetarë, është bërë raportimi i të dhënave në Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Shërbimeve Komunale. Është hartuar dokumenti i parë punues për fushat, rezultatet dhe treguesit e performancës. Në këtë dokument janë shqyrtuar 14 fusha të shërbimeve që i ofron komuna, nga të cilat janë synuar të arrihen 25 rezultate të rëndësishme për qytetarët, arritja e të cilave është paraparë të matet me 65 tregues nëpërmjet 203 të dhënave të ndryshme. Po ashtu, është vazhduar me monitorimin e transparencës komunale, më saktësisht në publikimin e informatave që lidhen me prokurimin publik nga komunat, si dhe publikimin e akteve të miratuara nga kryetarët dhe kuvendet e komunave. Në kuadër të aktiviteteve për të drejtat e njeriut, MAPL ka marrë pjesë në grupet punuese për hartimin e politikave, strategjive dhe hartimin e legjislacionit, si dhe ka zhvilluar indikatorët për matjen e performancës së komunave në këtë fushë. Gjatë kësaj periudhe në faqen zyrtare elektronike janë postuar gjithsej 211 informata, kurse në media janë publikuar 31 informata dhe 27 përgjigje për tema të caktuara të kërkuara nga gazetarët.

Gjatë kësaj periudhe, MAPL është përkushtuar në zbatimin e planit të personelit për vitin 2016. Në bashkëpunim me IKAP-in, janë organizuar trajnime për ngritjen e kapaciteteve të stafit të MAPL-së. Po ashtu, është bërë dorëzimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve për vitin 2017-2019. Sa i përket Auditimit të brendshëm, është hartuar Raporti vjetor i punës, janë zhvilluar auditime të brendshme, janë

mbajtur takime në mes të NJAB dhe Menaxhmentit të lartë të MAPL-së, si dhe konsultative të tjera këshilldhënie për ZKA-n. Në këtë fushë, MAPL ka inkorporuar rekomandimet e auditorit të brendshëm dhe të jashtëm në një dokument të vetëm, si dhe ka formuar ekipin monitorues, përgjegjës për sigurimin e zbatimit të rekomandimeve nga Njësitë përgjegjëse të ministrisë.

1. Zhvillimi dhe Zbatimi i Legjislacionit

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016, MAPL ka realizuar një numër madh të aktiviteteve në fushën e zhvillimit të legjislacionit, përmes hartimit të akteve ligjore dhe nënligjore si dhe dhënien e interpretimeve të caktuara për komunitet me qëllim të zbatimit më të lehtë të legjislacionit në fuqi. Në vijim janë paraqitur të dhënat në formë grafike për aktivitetet e zhvilluara:



Tab.1. Të dhënat për aktivitetet në fushën e zhvillimit dhe zbatimit të legjislacionit

Në kuadër të Programit Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2016, MAPL ka hartuar Projektligjin për Kryeqytetin e Republikës së Kosovës/Prishtinën, i cili është dërguar ne MF për vlerësim të ndikimit financiar dhe MIE për deklaratë të përputhshmërisë. Edhe pse është planifikuar Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave, i njëjti është shtyrë deri në deri në hartimin e koncept-dokumentit për kufijtë administrativ të komunave.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016 MAPL ka hartuar 3 rregullore dhe 1 Udhëzim Administrativ¹. Gjithashtu, janë hartuar 4 analiza që ndërlidhen me kompetencat e pushtetit lokal dhe legjislacionin për

¹ Rregulloren (QRK) Nr. 01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e miratuar në mbledhjen e 75 të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Vendimin Nr. 02/75, datë 18.02.2016;

Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për procedurën e themelimit, organizimin dhe kompetencat e komiteeve konsultative në komuna, i cili është nënshkruar me datën 21 tetor 2016 nga Ministri i MAPL-së;

Rregulloren (MAPL) Nr.01/2016 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, e nënshkruar me datën 31.10.2016 nga Ministri i MAPL-së;

Projekt-Rregullorja për Hartimin dhe Publikimin e Akteve të Komunës – Kjo rregullore është hartuar dhe ka kaluar të gjitha procedurat e konsultimit publik dhe paraprak. Kjo projekt-rregullore është në pritje të harmonizimit me projektligjin për aktet normative.

vetëqeverisje lokale, si dhe 8 Udhëzues nga fusha e vetëqeverisjes lokale. MAPL është përfaqësuar në grupe të ndryshme punuese për hartimin e Strategjive sektoriale, siç është ajo për pronë, të drejtat e njeriut dhe për sigurinë në bashkësi. Po ashtu janë hartuar 17 shkresa për komunat lidhur me informimin e tyre për ndryshimet në legjislacionin qendror që prek fushat e caktuara të pushtetit lokal

Në kuadër të konsultimit paraprak dhe procesit të vlerësimit të ligjshmërisë, MAPL ka ofruar mbështetje për komunat dhe ministritë në shqyrtimin e propozimeve dhe harmonizimin e tyre me legjislacionin për vetëqeverisje lokale. Në kuadër të konsultimit paraprak, të dhënat janë paraqitur në formë grafike si në vijim:




Tab.2. Të dhënat për aktivitetet e procesit të konsultimit paraprak

Monitorimi i punës së komunave ka vazhduar edhe përmes monitorimit të drejtpërdrejtë të organeve komunale. MAPL ka hartuar planin e vizitave në komuna dhe pyetësorin e integruar me të dhëna me qëllim të koordinimit më të mirë të sektorëve brenda MAPL-së dhe komunave. Bazuar në këtë plan janë monitoruar 38 komuna, për të cilat janë hartuar raportet e monitorimit. Përmes sistemit të teleprezencës, janë monitoruar gjithsej 328 mbledhje të kuvendeve të komunave². Është themeluar grupi koordinues i projektit “Solucione të IT-së për komuna”, si dhe tri nën-grupe: nëngrupi “intranet and building permit tracking system”, nëngrupi për ueb-faqe dhe teleprezenca, si dhe nëngrupi për performancë. MAPL në bashkëpunim projektin DEMOS kanë mbështetur hartimin e analizës nga kompania profesionale “Cactus” lidhur me vendosjen dhe funksionalizimin e teleprezencës.

MAPL ndërmarrë një pjesë të rëndësishme të veprimeve në lidhje me vlerësimin e ligjshmërisë së akteve të miratuara nga kuvendet e komunave. Të dhënat për numrin e mbledhjeve të monitoruara të kuvendeve të komunave, akteve të miratuara dhe procesin e rishikimit administrativ janë paraqitur në figurën 3.

Projekt-Rregullorja (MAPL) për Sistemin e Menaxhimit të Performances së Shërbimeve Komunale – Grupi punues ka zhvilluar draftin e parë të këtij akti, i cili ka kaluar fazën e konsultimeve publike.

² Ky sistem i monitorimit do të instalohet edhe në 4 komuna. Më saktësisht, është rishpallur tenderi për sigurimin dhe vendosjen e pajisjeve të teleprezencës në komunat: Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zvecan dhe Leposaviq.



Tab.3. Të dhënat nga procesi i mbikëqyrjes së komunave

Të dhënat për numrin e akteve të miratuara dhe procesin e rishikimit administrativ janë si në vijim:

- Komunat kanë miratuar 1690 akte. Prej tyre, MAPL ka dhënë 653 konfirmime të ligjshmërisë, kurse 1037 akte janë adresuar për vlerësim të ligjshmërisë në ministritë e linjës. Nga këto të fundit 92 janë adresuar përmes komisioneve sektoriale^[1]
- Gjatë periudhës Janar-Shtator, janë konstatuar 39 akte të kundërligjshme në 20 komuna, për të cilat janë paraqitur kërkesat për rishqyrtim. 17 akte të kundërligjshme janë harmonizuar sipas rekomandimit të autoritetit mbikëqyrës, ndërsa 22 nuk janë harmonizuar.

MAPL gjatë periudhës njëvjeçare ka hartuar 4 raporte të funksionimit të komunave (në baza periodike), 4 raporte për aktet e miratuara nga kuvendet e komunave, 5 raporte në fushën e financave lokale, 2 në lidhje me opinionet e auditorit për komuna për periudhat 2013/2014 dhe 2014/2015, 2 për investimet kapitale në komuna, 1 raport për skemëne granteve të financuara nga BE për komuna, 1 për marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkomunal dhe 2 për sfidat e komunave.

2. Zhvillimi i politikave nga fusha e vetëqeverisjes lokale

Gjatë periudhës raportuese, MAPL ka zbatuar aktivitetet e planifikuara në Strategjinë për Vetëqeverisje Lokale. Deri tani janë ndërmarrë një numër i veprimeve për harmonizimin e politikave zhvillimore me këtë strategji, duke përfshirë ndërlidhjen e saj me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019 dhe

^[1] Këto komisione janë shuar pas hyrjes në fuqi të Rregullores (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave. Procesi i vlerësimit të ligjshmërisë së akteve komunale është bërë konform Rregullores (QRK) Nr.01/2016 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave. MAPL ka organizuar punëtorinë me Kryesues të Kuvendeve të Komunave, Drejtorë të administratës në komuna, drejtorë të departamenteve ligjore të ministrive sektoriale, si dhe zyrtarë të tjerë komunal, për të sqaruar dispozitat e kësaj rregullore për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve komunale, si dhe procedurat e bashkëpunimit me ministritë e linjës.

me Strategjinë për Zhvillim Kombëtar 2016-2021. Në kuadër të aktiviteteve promovuese, janë botuar 500 ekzemplarë të Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale, si dhe është hartuar Plani promovues në përfshirje të institucioneve përgjegjëse për zbatimin saj. Me vendim të Qeverisë është themeluar Grupi Drejtues për zbatimin e SVL-së, për çka MAPL ka hartuar Termat e Referencës. Po ashtu, janë organizuar 5 punëtori regjionale për promovimin e Strategjisë për vetëqeverisje lokale si dhe janë mbajtur 2 takime me OSBE-në për rishikimin e planit të përbashkët për implementimin e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale. Strategjia është promovuar edhe në aktivitetin e përbashkët me Asociacionin e Komunave përmes projektit “Java e Komunave”.

Bazuar në obligimet që dalin nga strategjitë sektoriale, MAPL ka hartuar raportin narrativ për zbatimin e planit të veprimit të Strategjisë për Modernizimin e Administratës Publike, ndërsa së fundmi është përfshirë në Grupin Drejtues për hartimin e Strategjisë për Siguri në Bashkësi 2017-2022. Veç kësaj, MAPL është përfaqësuar në grupin punues për hartimin e Strategjisë për Decentralizim Fiskal dhe në Strategjinë për Pronë.

Në lidhje me raportimin, në përputhje me obligimet ligjore, janë hartuar 4 raporte të punës së MAPL-së për periudhat, 2 raporte për zbatimin e vendimeve të Qeverisë, 1 raport për obligimet që dalin nga dokumentet strategjike dhe koncept-dokumentet, 2 raporte për zbatimin e Strategjisë për VQL, si dhe analizat periodike të zbatimit të planit të punës së MAPL-së.

Duhet shtuar se MAPL ka avancuar procesin e brendshëm dhe të jashtëm të raportimit. Fokus i veçantë është vënë në dizajnimin e sistemit të integruar i raportimit në raport me komunat, si dhe në hartimin e Doracakut për Koordinim të Politikave. Është duke u punuar në finalizimin e pyetësorit të integruar, me qëllim të marrjes së informatave nga fusha të ndryshme të funksionimit të komunave. **Në bashkëpunim me USAID është mbajtur punëtorja për Sistemin e Integrit të Raportimit me zyrtarët komunal për integrimi evropiane dhe shoqërinë civile.** Në këtë periudhë është hartuar projekti ideor për krijimin e platformës softuerike për raportimin online të të dhënave, përmes së cilit synohet të avancohet procesi i menaxhimit të të dhënave edhe sa i përket vlerësimit të ligjshmërisë së akteve të komunave nga MAPL dhe ministrinë e linjës. Projekti është dorëzuar në organizatën vullnetare amerikane “Peace Corps in Kosovo”, e cila ka aprovuar projektin dhe do të ofroj mbështetje përmes angazhimit të një eksperti vullnetar për programimin e kësaj platforme.

Me qëllim të mbështetjes së komunave në implemtimin e legjislacionit për nxitjen e bashkëpunimit ndërkomunal, MAPL ka hartuar Doracakun për Bashkëpunimi ndërkomunal dhe komunal ndërkomëtar. Ky doracak është dorëzuar për publikim, ndërsa është financuar nga projekti DEMOS. Në këtë drejtim, janë realizuar edhe vizitat monitoruese në 38 komuna, nga të cilat janë kërkuar të gjitha marrëveshjet në fushën e bashkëpunimit ndërkomunal, si dhe janë realizuar 11 punëtori me komuna. Edhe në këtë periudhë ka vazhduar procesi i monitorimit të zbatimit të projekteve të bashkëpunimit ndërkomunal.

Në fushën e zhvillimit ekonomik lokal, aktivitetet janë shtrirë në zhvillimin e dokumenteve dhe politikave të caktuara që kanë ndikim në këtë aspekt, si dhe përkrahjen e komunave në zhvillimin e projekteve të caktuara kapitale. Gjatë kësaj periudhe, është plotësuar granti i përgjithshëm i financimit për komunat

që kanë popullsi nën 20 mijë banorë, me një grant shtesë prej 5 milion euro. Granti shtesë është përfshirë në qarkoret buxhetore për vitin 2017 dhe në projektligjin e buxhetit për vitin 2017.

Në procesin e zhvillimit të politikave nga fusha e vetëqeverisjes lokale, MAPL zhvilluar:

- Koncept-Dokumentin për menaxhimin e pronës komunale
- Koncept-Dokumentin për Akademinë për Vetëqeverisje Lokale (i pa finalizuar)
- Koncept-Dokumentit për Zhvillim Ekonomik-Lokal (i dorëzuar në SKQ)
- Koncept-Dokumentit për Zhvillimin Rajonal (Pas pranimit të opinionit nga Ministria e Financave do të dorëzohet në SQK (brenda muajit janar 2017).

Në përfshirje të institucioneve qendrore dhe lokale, organizatave ndërkombëtare, shoqërisë civile dhe medie, është mbajtur takimi për prezantimin e Analizës së të hyrave vetanake të komunave për 5 vitet e fundit. Gjithashtu është përgatiti Analiza e investimeve kapitale në komuna për periudhën 2011-2015 e cila është diskutuar me komuna në konferencën e realizuar në muajin dhjetor. Takimet kanë vazhduar edhe me Ministrinë e Financave përkitazi me vlerësimin e ligjshmërisë së Rregulloreve komunale për tarifa, ngarkesa dhe gjoba. Njëkohësisht janë përgatitur rekomandimet për Komisionin e Granteve për financimin e komunave për vitet 2017-2019. Në bashkëpunim me USAID/AKT-in në dhjetor 2016 është realizuar takimi lidhur me “Borxhet publike në zhvillimin e komunës. Me të njëjtin subjekt, për të përkrahur hartimin e strategjive për zhvillim socio-ekonomik lokal në fazën e parë janë përzgjedhur komunat: Gjilan, Obiliq, Shtërpçë dhe Graçanicë. Po ashtu, është përgatitur drafti i analizës së investimeve kapitale për komuna për periudhën 2011-2015. Sa u përket planifikimeve buxhetore, në përfshirje të MAPL-së, MPMS-së, MSH-së dhe MASHT-it, janë realizuar tri takime rajonale, ku janë përfshirë të gjitha komunat për planifikimin buxhetor 2017-2019. Përveç kësaj, është realizuar punëtorja për planifikimin e investimeve publike me katër komuna: Mitrovicë Veriore, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq.

3. Koordinimi institucional dhe promovimi ndërkombëtar i vetëqeverisjes lokale

MAPL ka koordinuar aktivitetet brenda dhe jashtë institucionit me qëllim të arritjes së objektivave të përcaktuara. Rëndësi e veçantë i është dhënë hartimit të Planit Vjetor të Punës së MAPL-së për vitin 2016 dhe Planit të Punës së MAPL-së për Qeveri 2016. Bazuar në Planin e Veprimit të Strategjisë për Vetëqeverisjen Lokale, MAPL ka hartuar kornizën e planifikimit të aktiviteteve për vitin 2017. Janë bërë vlerësimet periodike të zbatimit të planit të punës për periudhat raportuese. Njëkohësisht është punuar në avancimin e procesit të raportimit javor, përmes krijimit të formave të reja të raportimit që sigurojnë konsistencën e informatave.

Në hapin e koordinimit ndër-institucional, është ofruar mbështetja e përmes konsultimit paraprak gjatë hartimit të politikave nga institucionet e tjera, duke siguruar përputhshmërinë e tyre me legjislacionin për vetëqeverisje lokale. Koordinimi i aktiviteteve është bërë edhe me donatorë. Në muajin qershor, MAPL-ja ka marrë pjesë në takimin e parë të grupit sektorial të qeverisë me donatorët e vendit. Në këtë takim është bërë prezantimi për projektet e mbështetura dhe të realizuara bashkërisht me donatorët apo partnerët implementues, si dhe është bërë propozimi për përkrahjen e MAPL-së në studimin e fizibilitetit

të qeverisjes lokale në vend, si dhe tejkalimin e sfidave të komunave në përmbushjen e obligimeve që dalin nga agjenda evropiane. Lidhur me këtë, gjatë kësaj periudhe janë mbajtur gjithsejtë 24 me donatorë të ndryshëm që bashkëpunojnë me MAPL-në (GIZ, DEMOS, OSBE, KCSF, UNDP dhe AKK/KIE).

Në bashkëpunim me USAID-in janë caktuar temat e trajnimeve që do të mbështeten nga kjo organizatë, është siguruar financimi për botimin e “Profileve të Komunave” dhe mbështetja për hartimin e Komentarit të Ligjit për Vetëqeverisjes Lokale. Profilet e komunave janë shpërndarë në të gjitha komunat si dhe dokumenti është publikuar në ueb-faqen e MAPL-së. Gjithashtu, janë mbajtur 20 takime me partnerët/donatorët e tjerë (GIZ, DEMOS, OSBE, KCSF, UNDP dhe AKK/KIE) me qëllim të koordinimit të aktiviteteve për realizimin e planit të përbashkët për implementimin e Strategjisë së Vetëqeverisjes lokale, zbatimin e programit të trajnimeve për komunat, realizimin e Këshillimit të Përbashkët/Vizita Studimore me temë “Planet e integruara të komunave nga obligimet e agjendës evropiane 2016”, zbatimin e planit të punës së MAPL-së për vitin 2016, si dhe organizmin e konferencave informuese në komuna lidhur me MSA-në dhe përfitimet e saj.

Kujdes i veçantë i është kushtuar zhvillimit të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar me tri vendet fqinje: Shqipërinë, Malin e Zi dhe Maqedoninë. Në këtë drejtim, është realizuar projekti strategjik në kuadër të Programit për bashkëpunim ndërkufitar Kosovë-Shqipëri, si dhe është kontraktuar kompania nga KE e cila do të bëjë mbikëqyrjen e punimeve. Sa i përket pjesës së financimit nga MAPL, është bërë përgatitja e elaboratit të shpronësimit dhe fillimi i procedurave të shpronësimit nga komuna e Dragashit. Në këtë drejtim është bërë kërkesa për marrjen e pëlqimit nga MMPH si dhe është hartuar Draft-Marrëveshja e Mirëkuptimit në mes të MAPL-së dhe Komunës së Dragashit për realizimin e pjesës së projektit që përfshinë ndërtimin e linjës së tensionit të lartë dhe ndriçimit solar në pikën kufitare Shishtavec. MAPL ka nënshkruar edhe kontratën me një kompani për zbatimin e projektit “*Zhvillimi i Solucioneve të integruara të IT-se për komunat*”.

Në vijim është prezantuar procesi i implementimit të programeve të bashkëpunimit ndërkufitar me tri shtetet: Shqipëri, Maqedoni dhe Mali i Zi, si vijon:

Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar (Kosovë-Shqipëri) –

Gjatë kësaj periudhe është mbajtur takimi i parë për Project Steering Committee (PSC) në Kosovë ku është aprovuar Inception Report me anekse. Gjithashtu është mbajtur takimi i parë për Joint Monitoring Committee (JMC) në Kosovë ku janë aprovuar: RoP për JMC, prioritetet e thirrjes së ardhshme, përfituesit potencial, target grupet, plani vjetor i punës dhe plani komunikues për Zyrën e Sekretariatit të përbashkët Teknik. Në takimin e mbajtur në Prishtinë, më 3 Qershor 2016 është nënshkruar Marrëveshja e Partneritetit mes Kosovës dhe Shqipërisë. Marrëveshja përmban mënyrën e implementimit të TA Servis Kontratës dhe alokimin e fondeve nga vendi udhëheqës tek vendi partner. Po ashtu është mbajtur takimi bilateral në mes të Strukturave Operative në MAPL. Në takimin e dytë të mbajtur në muajin tetor 2016 për Project Steering Committee (PSC) në Shqipëri është aprovuar Interim Report. Gjatë kësaj periudhe janë organizuar: trajnimi për anëtarët e KPM për IPA CBC Shqipëri-Kosovë; takimi bilateral në mes Strukturave Operative në Prishtinë për të diskutuar lidhur me 1st CfP. Përveç kësaj, është bërë Thirrja e Parë për Projekt Propozime IPA II CBC programi AI-Ks, si dhe është mbyllur tenderi nga ana e Zyrës së BE-

së në Kosovë për realizimin e projektit strategjik për 85% të projektit që financohet nga ana e tyre. Kanë filluar procedurat në MAPL për shpalljen e tenderit për projektin strategjik 15% të financuar nga MAPL, si dhe është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit me Komunën e Dragashit dhe vendimi për ndarjen e mjeteve në kuadër të Ministrisë. Sa i përket punës së MAPL-së rreth Projektit Strategjik, procesi është duke vazhduar dhe punimet priten që të përfundojnë gjatë muajit Maj – Qershor 2017.

2. Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar (Kosovë – Mal i Zi 2011- 2013) – Gjatë periudhës raportuese është mbajtur takimi i parë i Project Steering Committee PSC (Service Contract) në Malin e Zi, ku është aprovuar Inception Report se bashku me anekse. Në takimi i dytë të Project Steering Committee PSC (Service Contract) mbajtur në Mal të Zi është aprovuar Raporti i parë Interim. Sa i përket takimit të parë të Joint Monitoring Committee (JMC) mbajtur në Kosovë me datë 17 Qershor 2016, janë aprovuar: RoP për JMC, Prioritetet e thirrjes së ardhshme, përfituesit potencial, target grupet, Plani vjetor i punës dhe plani Komunikues për Zyrën e Sekretariatit të përbashkët Teknik.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është realizuar vizita e parë monitoruese për 9 përfituesit e projekteve në Kosovë dhe 9 përfituesit në Malin e Zi. Janë përgatitur 18 raportet monitoruese për vizitën e parë (nga një raport i monitorimit për secilin projekt). Është realizuar vizita e dytë monitoruese për 9 përfituesit (projekte) në Kosovë dhe 9 përfituesit (projektet) në Malin e Zi, si dhe janë përgatitur 18 raportet monitoruese për vizitën e dytë.

Aktivitete të tjera të kryera gjatë kësaj periudhe janë:

- Mbajtja e dy trajnimeve për 9 përfituesit e projekteve në fushën e implementimit të projekteve dhe prokurimit.
- Në proces të negocimit është Marrëveshja Bilaterale dhe ajo e Partneritetit.
- Me datë 10-11.10.2016 është mbajtur trajnimi për përfituesit për IPA I;
- Ka përfunduar implementimi i TA Grantit të IPA I për programin e bashkëpunimit ndërkufitar në mes KS- MNE me 14 Tetor 2016.
- Është përgatitur Raporti final Narrativ, financiar dhe raporti i Auditorit për TA Grantin, ku gjithashtu është dërguar në Zyrën e BE-së në Prishtinë.

Programi i Bashkëpunimit Ndërkufitar (Kosovë – Maqedoni 2011- 2013) – 3 projekte kanë përfunduar implementimin ndërsa ka vazhduar implementimi i 3 projekteve të tjera të financuara nga ky program. Është mbajtur takimi i parë i Project Steering Commity, në të cilin është aprovuar në parim Inception Report me anekse. Me datë 30 Gusht 2016 në Kosovë është mbajtur takimi i dytë i Project Steering Commity, në të cilin është aprovuar Raporti i parë Interim. Është realizuar një vizitë monitoruese për 6 përfituesit (projektet) në Kosovë dhe 6 përfituesit (projektet) në Maqedoni si dhe janë hartuar 12 raporte të monitorimit (nga një raport i monitorimit për secilin projekt). Ka filluar përgatitja e dokumentacionit për hapjen e Thirrjes për Projekt Propozime. Pas lansimit të Thirrjes për propozime do të iniciohet Organizimi i një Forumi për kërkimin e Partnerëve në Kosovë. Me datë 2 Nëntor 2016 është mbajtur takim bilateral për të diskutuar rreth Thirrjes së parë për projekt propozime, trajnimin e anëtarëve të JMC. Me datë 30 Tetor – 1 Nëntor 2016 është mbajtur trajnimi për përfituesit potencial në Kosovë, kurse me datë 3 – 4 Nëntor trajnimi është mbajtur në Maqedoni. Është përgatitur ueb-faqja për programin Kosovë – Maqedoni, si dhe është përgatitur analiza për trajnim për anëtarët e JMC.

4. Agjenda evropiane

MAPL ka ndërmarrë veprime për koordinimin e aktiviteteve që kanë të bëjnë me përmbushjen e obligimeve që dalin nga procesi i integritetit evropian. Për të pasqyruar aktivitetet e komunave për vitin paraprak, është bërë hartimi i dokumenteve, si vijon: *Raporti i Planit të Veprimit Komunal nga MSA, Janar-Dhjetor 2015, dhe Analiza e përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për periudhën Janar–Dhjetor 2015*. Gjithashtu është bërë finalizimi i matricës gjithëpërfshirëse “*Obligimet e Komunave nga agjenda evropiane për vitin 2016*”, të cilat burojnë nga Dialogu i Procesit të Stabilizimit Asociimit, Programi Kombëtar për MSA-në, sfidat nga Raporti i Vendit 2015, si dhe sfidat nga Raporti i tretë për Kosovën i Komisionit Evropian nga Udhërrëfyesi për Liberalizim të Vizave. Nga kjo matricë janë përgatitur Planet individuale të veprimit për 38 komuna. Për të informuar komunat në këtë proces, janë adresuar shkresat zyrtare për komunat të cilat nuk kanë përmbushur obligimet nga agjenda evropiane.

MAPL ka përgatitur tri raporte periodike, përkatësisht: raportin për tremujorin e parë, tremujorin e dytë dhe të tretë për vitin 2016 lidhur me përmbushjen e obligimeve të komunave nga Agjenda Evropiane, ndërsa në proces të hartimit është Raporti i Komunave nga obligimet e agjendës evropiane Janar - Dhjetor 2016. Krahas kësaj, është përgatitur analiza 6 mujore për përmbushjen e obligimeve nga agjenda evropiane për MAPL-në dhe analiza 6 mujore për përmbushjen e obligimeve të komunave nga agjenda evropiane për komuna. Në proces të hartimit janë: analiza e përmbushjes së obligimeve të komunave nga agjenda evropiane Janar - Dhjetor 2016 dhe analiza e përmbushjes së obligimeve të MAPL-së nga PKZMSA Janar - Dhjetor 2016.

Gjatë kësaj periudhë, është raportuar edhe për Programin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së, si dhe raportet periodike për DPSA. Lidhur me koordinimin ndërinstytucional për procesin e integritetit evropian, janë mbajtur 67 takime të përbashkëta me MIE-në, Kolegjiumin për IE (AKK), institucionet e tjera qeveritare dhe joqeveritare. Në fund të muajit shtator është mbajtur takimi i Kolegjiumit të ZKIE-ve me AKK, ku kemi diskutuar mbi raportet individuale të komunave nga agjenda evropiane dhe funksionimin e zyrave për integritete evropiane në komuna.

Në muajin prill 2016, është mbajtur takimi i përbashkët me kryetarët e komunave, kryesuesit e kuvendeve të komunave, përfaqësuesit e shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare dhe mediave, me rastin e publikimit të Raportit të Monitorimit të Komunave për vitin 2015. MAPL ka realizuar vizitat në Komunën e Novobërdës dhe Leposaviqit për të adresuar obligimet ligjore për raportim në kuadër të PVMSA-së 2015, si dhe ka koordinuar aktivitetet me të gjitha komunat për obligimet e agjendës evropiane të vitit 2016.

Gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2016 MAPL ka mbajtur:

1. 5 punëtori regjionale me zyrtarë përkatës të komunave, duke përfshirë edhe zyrtarët komunal për integritete evropiane.
2. Këshillimin 4 ditor me ZKIE-të në Shqipëri dhe Mal të Zi;

3. Në bashkëpunim me UNDP-në është realizuar programi i trajnimit 5 ditor, për fushën e integritimeve evropiane për zyrtarët komunal për integritime evropiane dhe zyrtarët e MAPL-së;
4. Në kuadër të agjendës evropiane, në bashkëpunim me MIE dhe GIZ, janë mbajtur konferenca informuese për MSA-në në nivelin lokal në 3 regjione (Prishtinë, Pejë dhe Ferizaj).
5. Në bashkëpunim me UNDP-në është mbajtur punëtorja 5 ditore në Pejë, lidhur me organizimin dhe zbatimin e programit të trajnimit për ZKIE-të dhe Zyrtarët e MAPL-së për procesin e integritimit evropian, si dhe me GIZ-in është bërë realizimi i Konferencës Informuese për MSA-në, në Rajonin e Prishtinës, Pejës dhe të Ferizajt.

Në çështjet e koordinimit brenda MAPL-së për projekt-propozimet për IPA, MAPL ka dhënë 4 propozime në kuadër të “IPA indicative Multi Country Programme 2017”. Propozimet e dhëna kanë të bëjnë me:

- 1) Funkcionalizimin e Qendrave Rinore në Komuna;
- 2) Reformën e administratës komunale, përfshirë trajnimet speciale në ngritjen e nivelit të performancës komunale;
- 3) Fuqizimin e zyrtarëve komunal për integritime evropiane;
- 4) Mbështetje komunave për aplikim për leje mjedisore komunale.

Gjithashtu janë mbajtur takime të strukturave operative (JMC), si në vijim:

- 1) Takimi i parë i Komitetit të Përbashkët Drejtues për programin e IPA-së CBC ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë 2014-2020;
- 2) Takimi i gjashtë i mbajtur në Pejë i Komitetit të Përbashkët Drejtues për programin e IPA/CBC Mali i Zi – Kosovë;
- 3) Takimi i gjashtë i mbajtur në Podgoricë i Komitetit të Përbashkët Drejtues për programin e IPA/CBC Mali i Zi – Kosovë, përmbyllja e programit të 1 të thirrjes për propozime.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhe MAPL ka marrë pjesë në takimin e parë të Komitetit të Përbashkët Drejtues të IPA II, programi i BNK-së Kosovë – Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë 2014-2020. Gjatë periudhës në fjalë MAPL ka qenë prezentë në 14 takime të tjera, për procesin e integritimit evropian dhe obligimet që dalin nga ky proces. Gjatë kësaj periudhe është ofruar kontribut profesional në dhënien e komenteve për 9 akte ligjore dhe nënligjore, koncepte dokumente.

5. Ngritja e kapaciteteve institucionale të komunave

MAPL ka hartuar Planet për ngritje të kapaciteteve të komunave, për të mbështetur dhe ndikuar në zhvillimin e segmenteve të ndryshme të veprimtarisë komunale. Në kuadër të dokumenteve për ngritjen e kapaciteteve, janë hartuar:

- Plani i trajnimeve për vitin 2016;
- Plani i veçantë i trajnimeve për Komunat: Mitrovicë Veriore, Zveçan, Leposaviq dhe Zubin-Potok.
- Projekt propozimi për thirrje për financimin e projekteve të shoqërisë civile;

- Dokumenti sqarues për hapat e mëtejshëm të realizimit të detyrës nga Plani i Punës me temën “Skema e praktikantëve”.
- Janë përgatitur dokumentet informuese, të cilat janë publikuar në ueb faqen e MAPL-së, si vijon:
1) Broshura për kapacitetet e komunave; 2) Broshura informuese për Divizionin për Ngritje të Kapaciteteve; si dhe 3) Informatori për përfitimet e trajnimeve

Në bashkëpunim me IKAP-in, janë 146 trajnime, në të cilat janë trajnuar 2338 zyrtarë komunal. Trajnimet për zyrtarët e komunave janë ofruar edhe në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtar. Në bashkëpunim me OSBE-në, MAPL ka realizuar 16 trajnime fillestare për ish-pjesëtarët e mbrojtjes civile, në të cilat janë trajnuar 378 zyrtarë të komunave.


Gjithashtu, në bashkëpunim me DEMOS/Helvetas, është realizuar këshillimi i përbashkët dhe vizita studimore në Shqipëri dhe Mal të Zi, me zyrtarët komunal për integritet evropian. Projekti është titulluar “Roli i komunave në procesin e integritetit Evropian”, me ç ‘rast zyrtarët për integritet evropian të komunave kanë përfituar njohuri rreth praktikave të këtyre vendeve në procesin e integritetit evropian. Krahas kësaj, në bashkëpunim me UNDP-në, është përgatitur programi i trajnimit për fushën e integritetit evropian për zyrtarët komunal për integritet evropian dhe zyrtarët e MAPL-së. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 7 punëtori me komunat për transparencën komunale, raportimet buxhetore, planifikimet e investimeve, sistematizimin e vendeve të punës dhe menaxhimin e projekteve.

Pas miratimit të pakos ligjore për të drejtat e njeriut, MAPL ka aplikuar në programin e TAIEX, i cili është pranuar nga Zyra e Komisionit Evropian në Kosovë dhe pritet që gjatë periudhave raportuese të vazhdohet me procedurat e tjera.

Ne lidhje me investimet kapitale në komuna, ka përfunduar projektet si në vijim:

- 1) Projekti për renovimin e Shtëpisë së Kulturës në Komunën e Kllokotit.
- 2) Renovimi i Shtëpisë së Kulturës në Xërcë në Komunën e Rahovecit, dhe
- 3) Renovimi i objektit kulturor për ekspozitë në Komunën e Mitrovicës Veriore.

MAPL ka dhënë mbështetje të madhe në mbështetjen e projekteve të ndryshme kapitale të komunave. Gjatë kësaj periudhe janë aprovuar 44 projekte për 31 komuna, vlera e të cilave ka kap shumën prej 3,499,815.00€.



Tab.3. Projektet e financuara nga MAPL, 2016

Nga këto, kanë përfunduar 41 projekte, kurse në proces të përfundimit pas bartjes në vitin 2017 janë 3 projekte.

Nga fondet e BE-së (IPA I faza e VII) të gjitha projektet kanë përfunduar (*është bërë pranimi teknik*), në vlerë prej 15.3 milion€. Në këtë periudhë është përgatitur edhe drafti final i realizimit të projekteve për vitin 2015. Po ashtu ka rifilluar ndërtimi i objekteve komunale të mbetura nga IPA-faza e IV dhe V. Objektet nga IPA 1 Faza e VI kanë përfunduar të gjitha, përveç një objekti në Komunën e Graçanicës.

MAPL ka financuar edhe 17 projekte të organizatave joqeveritare në vlerën prej 203,643.00 euro, për zbatimin e objektivave të SVQL.

6. Performanca Komunale

MAPL ka bërë hapjen e raportimit të të dhënave për performancën e shërbimeve komunale për vitin 2015. Në hap me të, është bërë raportimi i të dhënave për Sistemin e Menaxhimit të Performancës së Shërbimeve Komunale sipas afateve të parapara, si dhe është hartuar Draft-Raporti vjetor i performancës së komunave për vitin 2015 dhe Draft-Raporti për funksionimin e administratës komunale për vitin 2015. Në bashkëpunim me USAID dhe UNDP, MAPL ka realizuar Mozaikun (anketën) me qytetarë në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës për vitin 2015, për cilësinë e ofrimit të shërbimeve nga organet komunale.

Gjatë periudhës raportuese është rishikuar sistemi i menaxhimit të performancës së komunave. Me qëllim të zhvillimit të fushave të treguesve për matjen e performancës së komunave, MAPL ka organizuar punëtori dy ditore me temën "*Rishikimi i Sistemit për Menaxhimin e Performancës së Shërbimeve Komunale*". Në kuadër të procesit të rishikimit të këtij sistemi, është hartuar dokumenti i parë punues për fushat, rezultatet dhe treguesit e performancës. Në këtë dokument janë shqyrtuar 14 fusha të shërbimeve që i ofron komuna, nga të cilat janë synuar të arrihen 25 rezultate të rëndësishme për qytetarët, arritja e të cilave është paraparë të matet me 65 tregues nëpërmjet 203 të dhënave të ndryshme. Ky dokument i punës është konsultuar nga palët e interesit, përfshirë ekspertët lokal, ministritë e linjës, shoqërinë civile, donatorët dhe partnerët tjerë të MAPL-së. Dokumenti i rishikimit të

sistemit të performancës ka përfunduar në muajin prill 2016. Më 29 prill 2016, dokumenti përfundimtar i SMP është diskutuar dhe miratuar në mbledhjen e Komitetit Këshillues të projektit për rishikimin e SMP.

Gjatë kësaj periudhe janë planifikuar veprimet për testimin e funksionimit të SMP-së. Prej tyre, 3 veprime janë realizuar, siç është përzgjedhja e mostrës për 10 komuna, trajnimi i koordinatorëve të performancës dhe zyrtarëve përgjegjës për mbledhjen e të dhënave, si dhe janë përgatitur dokumentet përkatëse për administrimin e pilotimit në komunat e përzgjedhura në bazë të kriterëve profesionale.

Në bashkëpunim me projektin DEMOS, MAPL ka zhvilluar procedurat e përzgjedhjes së një kompanie profesionale për dizajnimin e programit të ardhshëm elektronik për sistemin e menaxhimit të performancës së shërbimeve komunale (CSC/CSM) që do të jetë në funksion të MAPL- së, komunave dhe institucioneve të tjera në Kosovë. Në këtë fazë është kontraktuar kompania përkatëse për ridizajnimin e programit elektronik për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave nga komunat dhe është në diskutim programi elektronik – faza fillestare.

Është hartuar dokumenti i përgjithshëm i SMP-së, në kuadër të së cilit janë të përfshira disa dokumente themelore, si: modeli i SMP, korniza e SMPK, harta e treguesve, korniza e treguesve, dokumenti krahasues ndërmjet sistemit aktual dhe atij të rishikuar të SMP dhe kartela e treguesve me formularët 1 dhe 2 për mbledhjen dhe raportimin e të dhënave nga komunat. Po ashtu janë hartuar udhëzimet specifike për mënyrën e mbledhjes, verifikimit dhe raportimit të dokumentuar të 183 të dhënave për 67 tregues të SMP. Në kuadër të ofrimit të udhëzimeve, është hartuar dokumenti për formatin e raporteve të performancës së komunave, i cili gjithashtu është pjesë e dokumentit të përgjithshëm. Po ashtu është hartuar edhe një dokument i cili përcakton konceptet dhe metodologjitë kryesore për zhvillimin e anketës me qytetarët për matjen e kënaqshmërisë me shërbimet e ofruara nga komunat.

Është realizuar pilotimi i Sistemit për Menaxhimin e Performancës së Shërbimeve Komunale. Krahas kësaj është përfunduar dokumenti kryesor i Sistemit për Menaxhimin e Performancës së Shërbimeve Komunale. Po ashtu, është mbajtur takimi i Komitetit Këshillues për Rishikimin e SMP-së, ku janë miratuar dokumentet e përgatitura nga grupet punuese të eksperteve me qëllim të finalizimit të rishikimit të SMPK-së. Dokumentet e miratuara pas pilotimit të sistemit, kanë pësuar disa ndryshime: sistemi tani ka 14 fusha, 24 rezultate, 65 tregues dhe 203 të dhëna.

7. Promovimi i të drejtave të njeriut në Komuna

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016, MAPL është përfaqësuar në grupet punuese për hartimin e politikave, strategjive dhe hartimin e legjislacionit në fushën e të drejtave të njeriut. MAPL ka qenë pjesë e hartimit të Strategjisë Nacionale për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Plani i Veprimit 2016-2020. Në përputhje me rekomandimet dhe kërkesat e Avokatit të Popullit, është përgatitur raporti i cili adreson obligimet e komunave për respektimin e legjislacionit për barazi gjinore.

Gjatë kësaj periudhe, është dërguar pyetësori në komuna për raportimin e aktiviteteve në fushën e të drejtave të njeriut. Është dërguar pyetësori koordinatorëve lidhur me TIP Raportin nga (Departamenti i

Shtetit Amerikan) në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore. Gjithashtu, MAPL ka realizuar 5 takime me institucionet e nivelit qendror, ZKM/ZQM, ABGJ, Avokatin e Popullit dhe me Grupin Këshillëdhënës për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBT.

MAPL ka zhvilluar edhe indikatorët e performancës në fushën e të drejtave të njeriut, të drejtat familjare dhe sociale. Në bashkëpunim me GIZ-in dhe USAID janë mbajtur 10 punëtori: tema të ndryshme në kuadër të projektit SoRi siç është “Aplikimi për fondet e IPA-së”, “Të Avancojmë Kosovën së Bashku”, promovimin e pakos së re ligjore për të drejtat e njeriut, Ligjit për barazi gjinore, Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi dhe Ligjit për Avokatin e Popullit dhe shkëmbimit të përvojave me vendet tjera. Gjithashtu janë monitoruar rregullisht takimet me koordinatorët e OJQ-ve përfituese të projekteve të financuara nga MAPL, si dhe janë hartuar raportet mujore për implementimin e tyre.

Sipas agjendës së përbashkët me TAEX-in, janë hartuar dy projekt-propozimeve për TAEX, për personat me aftësi të kufizuara, përkatësisht:

- Qasja bazuar në të drejta, dhe
- Mbrojtja dhe respektimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara.

MAPL ka ofruar kontributin në zhvillimin e 12 dokumenteve strategjike dhe legjisacionit në fushën e të drejtave të njeriut.

MAPL ka qenë pjesë në shtyllën e Parandalimit sipas Strategjisë nacionale kundër trafikimit me njerëz, në këtë rast MAPL ka plotësuar draftin final të raportit të Gretas. Gjatë kësaj periudhe MAPL është angazhuar në organizimin e kampanjës vetëdijesuese kundër trafikimit me njerëz. Gjithashtu janë monitoruar 38 komuna për zbatimin e kornizës ligjore për të drejtat e fëmijëve. Sa i përket personave me aftësi të kufizuara, MAPL ka financuar shoqatën e të verbërve të Kosovës për projektin “E drejta për qasje të lirë, semaforët akustik”, i cili është implementuar në Komunën e Mitrovicës, Prizrenit dhe Pejës. Në këtë drejtim brenda MAPL-së janë angazhuar 6 persona me aftësi të kufizuara për 5 ditë për ofrim të shërbimeve.

Për më tepër, është bërë informimi i komunave lidhur obligimet që dalin nga Strategjia dhe Planit të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Për këtë qëllim janë realizuar vizita në të gjitha komunat, përjashtimisht në: Mitrovicën Veriore, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan. Në kuadër të vizitave komunat janë grumbulluar të dhënat lidhur me zbatimin e Ligjit për përdorimin e gjuhëve.

Krahas tyre, MAPL ka hartuar 19 raporte të ndryshme në fushën e të drejtave të njeriut, përfshirë: barazinë gjinore, funksionimin e NJDNJK-ve në komuna, kundërtrafikim, të drejtat e komuniteteve, përdorim të gjuhëve, të drejtat e fëmijëve, etj.

8. Promovimi i transparencës

MAPL ka realizuar aktivitete për zhvillimin e transparencës në komuna edhe gjatë vitit 2016. Gjatë periudhës në fjalë, ka vazhduar monitorimi i faqeve zyrtare elektronike të komunave. Monitorimi është

fokusuar në publikimin e rregulloreve, vendimeve, njoftimeve për mbledhjet e kuvendeve komunale, njoftimeve për debatet publike me qytetarë, publikimin e procesverbaleve të mbledhjeve të kuvendeve të komunave, funksionimin e linkut për qasje në dokumente publike, publikimin e dokumenteve financiare, si dhe publikimin e dokumenteve në gjuhët zyrtare. Gjithashtu, MAPL ka monitoruar transparencën në fushën e prokurimit publik të komunave. Në veçanti është monitoruar publikimi i akteve të kryetarit të komunës bazuar në ndryshimet e Udhëzimit Administrative për Transparencë në Komuna Nr. 01/2015. Në bashkërendim me Zyrën e Gazetës Zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe USAID-in, përkatësisht projektin “*Partneritetet për Zhvillim*”, janë mbajtur 3 punëtori në komuna, me qëllim të publikimit të akteve në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në raport me komunat, MAPL ka informuar komunat lidhur me obligimet ligjore për hartimin e planeve për transparencë. Është adresuar shkresa për caktimin e zyrtarëve për qasje në dokumente zyrtare në komunat: Mitrovicë Veriore, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan. Veç kësaj, në bashkëpunim me ZKM-në dhe OSBE-në janë mbajtur 5 punëtori regjionale (Prizren, Mitrovicë, Pejë Gjilan dhe Prishtinë) lidhur me Ligjin për qasje në dokumente publike.

MAPL ka koordinuar veprimet me komunat dhe shoqërinë civile në zhvillimin e kuadrit ligjor dhe dokumenteve të tjera me ndikim në transparencë. Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 19 punëtori me komunat me përfshirje të shoqërinë civile, lidhur me aktivitetet e kësaj fushe, përfshirë: Hartimin e indikatorëve për transparencë në komuna; Ndryshimin e Udhëzimit Administrativ 01/2015 për transparencë komunale; Ndryshimin dhe plotësimin e Draft-Rregulloreve komunale për transparencë në pajtueshmëri me Udhëzimin e ri Administrativ për transparencë në komuna; Hartimin e Model-Planit për pjesëmarrjen e qytetarëve në komuna; Transparencën e prokurimit në komuna, etj

Me qëllim të pasqyimit të aktiviteteve në lidhje me transparencën e komunave, janë hartuar 6 raporte. Ndërsa, për të adresuar veprimet që ndikojnë në përmirësimin e transparencës komunale, në komuna është dërguar *Shkresa Rekomanduese* lidhur me progresin e planit të veprimit për transparencë.

Gjatë kësaj periudhe në faqen zyrtare elektronike janë postuar gjithsej 211 informata përfshirë këtu informata nga aktivitete ditore të Ministrisë, vendime, raporte financiare, dokumente strategjike, raporte për procesin e integritetit evropian, thirrje për propozime, dhe dokumente të tjera. Po ashtu në media janë publikuar 31 informata dhe 27 përgjigje për tema të caktuara të kërkuara nga gazetarët. Në kuadër të ngritjes së transparencës në Komuna ka vazhduar projekti për ri-dizajnimin e ueb-faqeve të komunave dhe transmetimin on-line të mbledhjeve të Kuvendeve të Komunave.

9. Administrata dhe Financat

Gjatë kësaj periudhe janë zhvilluar nëntë (9) procedura të rekrutimit. Në bashkëpunim me IKAP-in, kanë vazhduar aktivitetet për organizimin e trajnimeve për stafin e MAPL-së. Po ashtu janë ofruar të dhënat e nevojshme për Agjensionin kundër Korrupsion, si dhe është bërë procedimi i përgjigjeve dhe raporteve të kërkuara nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës. DBNJ ka punuar edhe në ofrimin e të dhënave për përcaktimin e titujve sipas katalogut. Në këtë periudhe janë dërguar edhe dy raporte tremujore në MAP mbi strukturën etnike dhe gjinore. DBNJ ka proceduar kërkesa për pushime vjetore, mjekësore dhe të përdëllimit po ashtu ka përgatitur draft vendime për komisione intervistuese, udhëtime zyrtare dhe pushim të lehonisë. Gjatë periudhës raportuese numri i shërbyesve civil në MAPL është 126, prej të cilëve 67 meshkuj dhe 59 femra. Kurse, sa i përket përbërjes etnike janë :104 shqiptar, 20 serb dhe 2 turq.

Përgatitja e CPO-ve dhe zotimi i mjeteve për furnitor. Hapja dhe mbyllja e avancave dhe mbyllja e kredit karteleve. Çdo muaj përgatitet dhe dorëzohet Raporti për faturat e papaguara. Në bashkëpunim me kërkesat e Departamenteve të tjera të MAPL-së, është dorëzuar KASH për vitin 2017-2019. Gjithashtu, është përgatitur kërkesa e parë buxhetore dhe qarkorja e parë, e cila është dorëzuar në MF. Janë mbajtur Dëgjimet Buxhetore në Ministrin e Financave lidhur me kërkesën buxhetore të MAPL-së për vitet 2017-2019. Janë dorëzuar kërkesat për rialokim të mjeteve kapitale si dhe ndryshimet e nevojshme në KESH plan. Në këtë periudhë ka vazhduar sigurimi i kodeve të projekteve për projektet kapitale që bashkë financohen me komuna. Raportimi në baza tre mujore, 6 mujore dhe nëntëmujore mbi monitorimin e projekteve kapitale në Sistemin e PIP-ave.

Janë përgatitur dhe janë dorëzuar barazimet me Ministrin e Financave për periudhën 3 mujore, 6 mujore dhe 9 mujore. Në vazhdimësi janë bërë raportet e kontabilitetit (Çdo muaj) si dhe është bërë regjistrimi i pasurisë të MAPL-se dhe investimeve kapitale për komuna. Në vazhdimësi dërgohen shkruesat në Ministrin e Financave për bartjen e projekteve kapitale në komuna dhe dorëzimi i lëndëve që komunat i regjistrojnë pasurinë pronë të tyre.

Janë ofruar shërbime për përkthime simultante dhe me shkrim në gjuhët serbe dhe angleze si dhe lektorimi, ofrimi i shërbimeve të IT-së, shërbimet e Servisimit, mirëmbajtjes, pastrimit si dhe furnizimit me derivate të veturave, shpërndarja e materialeve nga depoja sipas kërkesave të zyrtarëve të MAPL-së, mirëmbajtjen e pajisjeve të teknologjisë informative si dhe shërbime të tjera në pranimin dhe shpërndarjen e lëndëve elektronike.

10. Auditimi

Njësia e Auditimit të Brendshme në MAPL për periudhën janar-dhjetor ka kryer të gjitha detyrat-aktivitetet e planifikuara me Planin vjetor për vitin 2016, të paraqitura kronologjikisht në vijim:

- Kryerja e vlerësimit të punonjësve-auditorëve të NJAB-it për vitin 2015;
- Raporti vjetor për punën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB) në vitin 2015 dhe procedimi i të njëjtit në Njësinë Qendrore të Auditimit të Brendshëm/Ministria e Financave dhe Menaxhmentit të lartë të MAPL-së, datë 29.01.2016;
- Auditimi: “Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore-Menaxhimi i të gjitha pushimeve të Shërbyesve Civil” bartur nga viti 2015. Raporti final proceduar menaxhmentit të MAPL-së me datë 15.02.2016 (Plani për adresim 17.03.2016);
- Takimi i I-rë, mbajtur me Komitetin e Auditimit të Brendshëm (KAB), datë 02.03.2016 në përbërja të re;
- Auditimi: “Sistemi i Menaxhimit të Prokurimit”, Raporti final proceduar menaxhmentit të MAPL-së me datë 13.04.2016 (Plani për adresim 14.06.2016);
- Raporti i tremujorit të parë -TM1, proceduar te menaxhmenti i lartë i MAPL-së, KAB-i dhe NJQH/AB-MF me 15.04.2016;
- Auditimi: “Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit, përfshirë edhe kategorinë ekonomike Subvencionet & Transferet”, Raporti final proceduar menaxhmentit të MAPL-së me datë 14.04.2016 (Plani për adresim 11.05.2016);
- Raporti i tremujorit të parë -TM1, proceduar te menaxhmenti i lartë i MAPL-së, KAB-i dhe NJQH/AB-MF me 15.04.2016;
- Trajnim i mbajtur me 07.04.2016, organizuar nga Thesari (përmes NjQ/AB për përdorimin e link-ut për raportim elektronik të NJAB-it në NjQ/AB;
- Takimi i II-të, mbajtur me Komitetin e Auditimit të Brendshëm (KAB), datë 22.04.2016;
- Takimi i III-të i KAB-it me menaxhmentin e lartë të MAPL-së ,datë 01.07.2016;
- Auditimi: “Sistemi i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore”-Raporti final, proceduar menaxhmentit me datë 13.07.2016 (Plani për adresim ende nuk është pranuar);
- Raporti i tremujorit të dytë-TM2, proceduar te menaxhmenti i lartë i MAPL-së, KAB-i dhe NJQH/AB-MF me datë 15/07/2016;
- Pjesëmarrja (një auditor-e) në ligjërata të organizuara nga NJQH/AB-MF për Çertifikim të Auditorëve të Brendshëm në Sektorin Publik- pesë module, filluar me datë 05.09.2016 deri me datë 07.10.2016 (një auditore e NJAB-it);
- Auditimi: “Sistemi i Menaxhimit të Logjistikës- Menaxhimi i Automjeteve dhe TI-së. Raporti final proceduar me 29.09.2016 (plani për adresim ende i pa pranuar;
- Takimi i IV-të i KAB-it me NJAB dhe menaxhmentin e MAPL-së, datë 30.09.2016.
- Raporti i tremujorit të tretë –TM3, është duke u hartuar dhe do të procedohet me 15.10.2016.

- Pjesëmarrje në tajnim dhe nënshtrimi i auditorëve në provimin për “Certifikimi në Programin Kombëtar të Trajnimit për Auditor të Brendshëm të Sektorit Publik” (dy zyrtarët e auditimit kanë marrë nga 5 ditë pushim studimor).
- Hartimi i Planit Strategjik 2017-2019 dhe Vjetor 2017, aprovimi nga KAB, ZKA dhe miratimi nga Ministri, si dhe procedimi në NJQH/AB-MF;
- Monitorimi dhe rishikimi i aktiviteteve të auditimit të brendshëm Nga NJQH/AB-MF) në NJAB/MAPL, (filluar nga kërkesa fillestare, datë 18.11.2016 e deri në marrjen e Raportit, datë 27.12.2016);
- Me datë 19.12.2017 është mbajtur takimi i V-të me NjAB-in dhe menaxhmentin e lartë të MAPL-së (shtesë: procesverbali i takimit);
- Gjatë këtij tremujori janë mbajtur edhe takime konsultative dhe këshillëdhënëse me Sekretaren e Përgjithshme-ZKA.
- Dhënia e mundësisë së pjesëmarrjes së dy auditorëve në procesin e Çertifikimit, organizuar nga NJQH/AB për Çertifikim(aprovimi i pushimit studimor prej 5 ditë pune).
- Raporti i final i Auditimit me temën: “Menaxhimi i buxhetit përfshirë subvencionet dhe transferet” (përfunduar me 12.01.2016);
- Deri në funde të Raportimit vjetor 2016 (31.01.2017) do të përfundohet edhe auditimi me temën: “Menaxhimi i investimeve kapitale”.

11. Prokurimi

Divizioni i prokurimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016 ka zhvilluar 29 aktiviteteve të prokurimit, prej të cilave: 3 tender, 11 kuotime të çmimeve dhe 2 kuotime të çmimeve – rishpallje, 4 kuotime çmimesh–rishpallje ku 2 prej tyre rishpallje të anuluar dhe 15 janë kuotime të çmimeve me vlerë minimale (Blerje minimale).